

PËRMBLEDHJE INFORMUESE

Shqipëria

Ekonomia e Shqipërisë u rrit, e mbështetur nga sektorët e shërbimeve dhe ndërtimit, veçanërisht turizmi.

Inflacioni mbeti nën objektivin e Bankës së Shqipërisë.

Borxhi publik vijoi rënien, duke zgbritur në 53.2 për qind të PBB-së në fund të vitit 2025.

Bilanci i llogarisë korrente u përmirësua, i mbështetur nga eksportet e shërbimeve të nxitura nga turizmi, pavarësisht dobësimit të eksporteve të mallrave për shkak të forcimit të monedhës vendase dhe rritjes së kostove të punës.

Shqipëria po krijon lidhje të reja tregtare për eksportin e mallrave në nivele të krahasueshme me vendet e rajonit. Megjithatë këto zgjasin më shumë se në vendet e tjera të Ballkanit, shumica mbeten afatshkurtra – vetëm 36 për qind mbijetojnë vitin e parë dhe vetëm 4 për qind zgjasin mbi pesë vjet.

Papunësia pësoi rënie, por kjo kryesisht pasqyron tkurrjen e fuqisë punëtore për shkak të emigracionit dhe plakjes së popullsisë, sesa një rritje të fortë të punësimit. Shqipëria mbetet një ndër vendet e rajonit me emigrimin më të lartë për frymë dhe ata që qëndrojnë përballen me pengesa të vazhdueshme në tregun e punës. Kujdesi dhe përgjegjësitë familjare mbajnë gratë jashtë këtij tregu, veçanërisht grupmosha 25–54 vjeç, ndërsa papunësia tek të rinjtë është në nivelin 21.5 për qind, mbi mesataren e BE-së që është 14.7 për qind.


Ekonomia e Shqipërisë vijon të tregojë qëndrueshmëri, por ruajtja e këtij momenti kërkon reforma të guximshme strukturore. Rruga përpara është e qartë: përsheptimi i reformave drejt anëtarësimit në BE, më shumë investime në kapitalin njerëzor dhe infrastrukturën digjitale, si dhe mobilizimi i kapitalit privat do të nxisë investimet, krijojë vende pune dhe përsheptojë konvergencën me BE-në.

Massimiliano Paolucci
 Menaxher i Zyrës së Grupit të Bankës Botërore për Shqipërinë


Rritja ekonomike e Shqipërisë parashikohet të ngadalësohet, sepse çmimet më të larta të energjisë dhe ndërprerjet e tregtisë të lidhura me situatën në Lindjen e Mesme po ndikojnë negativisht në fuqinë blerëse. Ruajtja e trendit të rritjes ekonomike, në kushtet kur fuqia punëtore po tkurret, kërkon mobilizimin e kapitalit njerëzor të pashfrytëzuar, përmes reformimit të skemave të përfitimeve, lehtësimit të kufizimeve për kujdesin ndaj fëmijëve, forcimit të formimit profesional, dhe zgjerimit të punësimit për të rinjtë dhe gratë.

Rritja reale e PBB-së


Në përqindje


Përbërja e Rritjes Vjetore

Në Pikë Përqindje



Burimi: Zyrat kombëtare të statistikave dhe vlerësimet e stafit të Bankës Botërore.
 Shënimi: BP = Ballkani Perëndimor gjashtë vendet; e = vlerësim.



Për më shumë informacion dhe edicionet e mëparshme të Raportit të Rregullt Ekonomik të Ballkanit Perëndimor, kliko [këtu](#).